

ALLEA

PRIORITETET STRATEGJIKE 2019-2024

ALLEA është Federata Europiane e Akademive të Shkencave Shoqërore dhe Natyrore.

Që prej themelimit të saj në vitin 1994, ALLEA flet në emër të anëtarëve të saj dhe kërkon promovimin e shkencës si një e mirë publike botërore. Shkenca kuptohet si përfshirja e të gjitha formave të prodhimit të dijes, bazuar mbi të dhëna të vërtetueshme dhe të përsëritshme, kështu duke përfshirë të gjitha disiplinat e hulumtimit shkencor.

ALLEA është e regjistruar sipas legjislacionit Holandez si një shoqatë me anëtarësi ndërkombëtare me kapacitete të plota ligjore.

Anëtarët

Duke qenë rrjeti më gjithëpërfshirës i akademive në Europë, ALLEA bashkon më shumë se 50 akademi nga mbi 40 vende të rajonit të Këshillit të Europës, me përfshirje të pothuajse të gjitha shteteve anëtare të BE.

Akademitë anëtare janë organe vetë-qeverisëse me studiues të shquar nga të gjitha fushat e shkencave natyrore, shoqërore dhe arteve. Ato përmbajnë një burim të veçantë njerëzor të ekselencës intelektuale, eksperiencës dhe dijes përmes disiplinave të ndryshme, kushtuar përparimit të shkencës dhe hulumtimit në Europë dhe në botë.

Vlerat dhe Vizioni

Prioritetet strategjike të ALLEA-s formohen dhe nxiten nga vlerat dhe vizioni i saj. ALLEA frymëzohet nga tradita kulturore, shkencore dhe humaniste e Iluminizmit European, e cila kryesohej nga koncepte të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

Duke iu përmbajtur këtyre vlerave, ALLEA kërkon të japi kontributin e saj në një shkencë universale dhe pa kufi. Vizioni i ALLEA-s i tejkalon kufijtë kombëtarë dhe të disiplinave të ndryshme shkencore.

ALLEA është e pavarur nga interesat politike, fetare apo ekonomike dhe synon të promovojë dhe mbrojë ekselencën në kërkimin shkencor, njëkohësisht duke mbajtur standarde të larta etike dhe duke ruajtur lirinë akademike të çdokujt të përfshirë në procesin shkencor.

Shërben akademitë europiane
Përforcon rolin e shkencës në shoqëri
Mundëson një burim të besueshëm njohurish
Këshillon politikëbërësit dhe publikun
Krijon kushtet për hulumtim

ALLEA flet në emër të anëtareve të saj dhe kërkon promovimin e shkencës si një
e mirë publike botërore.

MISIONI

Shërbimi ndaj akademive europiane dhe përforcimi i rolit të shkencës në shoqëri

ALLEA i zhvillon aktivitetet e saj për të shërbyer anëtarët e saj dhe për të përfaqësuar interesat e tyre në shkëmbimet shkencë-politikë-shoqëri në nivel evropian dhe botëror. ALLEA punon drejt lehtësimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit midis Akademive anëtare dhe u mundëson atyre një forum ku nismat e tyre të zgjerohen nga niveli kombëtar në atë evropian dhe botëror.

Duke njohur shumëllojshmërinë institucionale të pjesëtarëve të saj, ALLEA synon të sigurojë se të gjitha akademitë do të përfitojnë nga të qenit anëtare, nga ndërtimi i kapaciteteve, si dhe nga mbrojtja e autonomisë së tyre aty ku nevojitet. Anëtarët e ALLEA-s marrin pjesë në aktivitetet e federatës dhe proceset e saj me anë të konsultimeve të rregullta, përmes pjesëmarrjes së delegatëve të tyre në grupe pune, komiteteve të ekspertëve apo bordit qeverisës dhe përmes debateve gjatë asambleve të përgjithshme vjetore.

Mundësimi i një burimi të besueshëm njohurish për politikëbërësit dhe publikun

ALLEA promovon konceptin e një bashkëpunimi me të vërtetë ndërkombëtar dhe përmes fushave të ndryshme për të krijuar zgjidhje sa më të mira nga ana shkencore për sfidat dhe nevojat e shoqërive tona, duke marrë parasysh rëndësinë e njëjtë që kanë shkenca, teknologjia, kultura dhe shoqëria.

ALLEA i përfshin akademitë europiane në zhvillimin e politikave të bazuara në shkencë duke u mundësuar politikëbërësve dhe publikut të përgjithshëm ekspertizë shkencore nga disiplina të ndryshme, si dhe prova e fakte. ALLEA veçanërisht i përfshin pjesëtarët e saj në Mekanizmin e Këshillimit Shkencor

(SAM) të Komisionit European përmes SAPEA (Këshillim Shkencor për Politikën nga Akademitë Europiane).

Krijimi i kushteve themelore për shkencën dhe hulumtimin në Europë

ALLEA kërkon t'i ruajë dhe t'i përmirësojë kushtet themelore për shkencën dhe hulumtimin në Europë duke dhënë kontributin e saj për politikën shkencore në nivel europian dhe në organe të tjera vendimmarrëse ndërkombëtare të nivelit të lartë.

Kompetencat themelore të ALLEA përfshijnë etikën e hulumtimit dhe integritetin e tij, planifikimin dhe zbatimin e Zonës Kërkimore Europiane (ERA), strukturën e programeve kërkimore europiane, shkencë dhe të dhëna të hapura, infrastrukturë për kërkimin digjital, ashtu si dhe bazat për pronësinë ligjore dhe intelektuale të cilat mundësojnë shkencë dhe hulumtim të shkëlqyer në Europë.

ALLEA ka, përveç të tjerash, grupe pune në fushat e politikave të hulumtimit, shkencës dhe etikës, të drejtave të pronësisë intelektuale, shkencave shoqërore digjitale dhe edukimit shkencor. Në përgjigje të zhvillimeve dhe sfidave të reja, ALLEA ndërmerr dhe nisim të tjera sipas nevojës.

Objektivat strategjike

1. Shërbimi i akademive dhe lehtësimi i bashkëpunimit

Krijimi i mundësisë për Akademitë anëtare për mënyra që të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga aktivitetet e ALLEA; të lehtësojë shkëmbimet ndër-akademike dhe të harmonizojë bashkëpunimin midis rrjeteve të akademive europiane.

Të mbështesë Akademitë anëtare në përpjekjet e tyre për të arritur synime europiane dhe ndërkombëtare në ekselencën shkencore duke mundësuar udhëzimet më të mira nga ana praktike.

Të përfshijë akademitë, shkencëtarët dhe studiuesit në mënyrë aktive në debatet publike, veçanërisht ato mbi vlerat, identitetin dhe të ardhmen e Europës.

2. Përmirësimi i kushteve themelore për shkencën dhe hulumtimin

Ndikimi në politikën europiane kërkimore, veçanërisht ERA dhe strukturat e programeve kërkimore të BE dhe promovimi i mekanizmave të ndryshëm për përhapjen e gjerë dhe aksesin ndaj punës kërkimore përmes shkencës së hapur.

Të nxisë dhe promovojë ekselencën, studimet përmes disiplinave të ndryshme, lëvizshmërinë, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndikimin në mirëqenien sociale dhe përfundimin e rritjes ekonomike.

Të lehtësoje, respektojë dhe promovojë punën studimore dhe bashkëpunimin për vlerat, integrimin dhe identitetin evropian.

3. Këshillim shkencor i pavarur për politikëbërësit dhe shoqërinë
Mundësimi i mënyrave për Akademitë europiane që të japin këshillim shkencor për politikëbërësit që të jetë i përshtatshëm, i pavarur dhe në disiplina të ndryshme.

Të përfshijë akademitë në Mekanizmin e Këshillimit Shkencor të Komisionit European përmes projektit SAPEA.

Të mundësojë që Akademitë të japin idetë e tyre në debatet për politikat shkencore në nivele europiane dhe ndërkombëtare dhe të zhvillojë praktikatat më të mira për akademitë që të përfshihen në debate publike dhe të ndërveprojnë me aktorë të rëndësishëm të politikave dhe mediave.

4. Lehtësimi i praktikave të mira kërkimore

Këshillimi dhe puna me institucione europiane dhe aktorë të tjerë mbi praktikatat më të mira për etikën dhe integritetin kërkimor.

Të nxisë dhe të sigurojë standarde të larta etike në shkencë dhe hulumtim, në vlerësimin e punës kërkimore, ashtu si dhe në komunikimin dhe përhapjen e shkencës.

Të mundësojë udhëzime se si të parandalohen sjelljet e pahijshme në punën kërkimore dhe t'u mundësojë studiuesve të ndjekin praktikatat më të mira, veçanërisht përmes Kodit European të Sjelljes për Integritetin Kërkimor.

5. Mbrojtja e lirisë akademike dhe shkencës së besueshme

Synon të mbrojë lirinë akademike dhe autonominë e shkencës dhe punës kërkimore.

Jep ndihmë dhe këshillim për akademitë në kushte të vështira dhe flet publikisht për autonominë dhe vetë-qeverisjen e institucioneve shkencore.

Promovon besimin publik në shkencë dhe arsyetimin shkencor nëpër debate publike dhe jep kontribut në debate në lidhje me të vërtetën, besimin dhe ekspertizën, duke vepruar kundra keq-informimit aty ku nevojitet.

6. Përforsimi i shumëllojshmërisë dhe përfshirjes

Puna drejt një mjedisi shkencor gjithëpërfshirës, të shumëllojshëm dhe mikpritës, i cili t'i lejojë shkencëtarët që pavarësisht identiteteve të tyre dhe mjedisit prej të cilit vijnë, të arrijnë maksimumin e aftësive të tyre.

Të bashkëpunojë me hulumtues në hapat e parë të karrierës së tyre dhe të punojë me organizata nga sektorë të tjerë për çështje të interesit të përbashkët.

Të promovojë traditën e shumëllojshme kulturore, shkencore dhe humaniste të Europës në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të përforcojë një njohje të Europës, si një Europë me shumë aspekte, intelektuale, e hapur dhe e gjallërishme.

7. Të mendojë dhe veprojë botërisht

Të promovojë shkencën si një e mirë publike botërore dhe pa kufij, të përfshihet në aktivitete shkencore diplomatike europiane dhe botërore aty ku është e përshtatshme.

Të përfaqësojë interesat e akademive në Europë dhe në botë duke zgjeruar ndikimin dhe praninë e ALLEA në shkëmbimet botërore shkencë-politikë-shoqëri dhe në media.

Të kërkojë bashkëpunim më të afërt me organizata ndërkombëtare të ngjashme, përfshirë ato nga sistemi i Kombeve të Bashkuara, ashtu si dhe me shoqata e rrjete akademike rajonale.

Një plan zbatimi dhe strategji komunikimi do të përcaktojë veprimet praktike për objektivat strategjike të ALLEA.